



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 122**

**19 shtator**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr. 550, datë 22.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.....	6875
Vendim i KM nr. 551, datë 22.8.2012	Për miratimin e kriterëve për përzgjedhjen, rekrutimin e trajnimit të personelit të regjistrimit, si dhe përcaktimin e detyrave e të përgjegjësive të personelit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore.....	6877
Vendim i KM nr. 552, datë 22.8.2012	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.3.2010 për çështjen nr. 6397/04 “Bushati dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.....	6885
Vendim i KM nr. 553, datë 22.8.2012	Për miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “Epoka”.....	6885
Vendim i KM nr. 554, datë 22.8.2012	Për dhënie licence për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Qendra Akademike e Lezhës” (Lezha Academic Center).....	6886
Vendim i KM nr. 555, datë 22.8.2012	Për dhënie licence për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Shkolla Ndërkombëtare e Shqipërisë” (Albanian International School), Tiranë.....	6886
Vendim i KM nr. 556, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 129, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Unaza e Madhe e Tiranës”.....	6887

Vendim i KM nr. 557, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 133, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës Qafëploçë”.....	6888
Vendim i KM nr. 558, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 334, datë 16.5.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkozet-Durrës”.....	6888
Vendim i KM nr. 559, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 130, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Maminas-Gjiri i Lalzit”.....	6889
Vendim i KM nr. 560, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.....	6889
Vendim i KM nr. 561, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 131, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Unaza Lindore Shkodër”.....	6890
Vendim i KM nr. 562, datë 22.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 132, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe drufrutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë)”.....	6891
Vendim i KM nr. 563, datë 22.8.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Poshnjë të qarkut të Beratit.....	6891
Vendim i KM nr. 608, datë 5.9.2012	Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre.....	6892
Udhëzim i MF dhe MPPT nr. 3488/1, datë 23.8.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 6.1.2012 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrës”.....	6898

**VENDIM**

**Nr. 550, datë 22.8.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 825, DATË 13.10.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË MBETJEVE QË LEJOHEN TË  
IMPORTOHEN PËR QËLLIME PËRDORIMI, RICIKLIMI DHE PËRPUNIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe pikës 8 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
  - a) Aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  - b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Mbetjet që do të lejohen të importohen duhet të jenë të listuara njëkohësisht në të tria listat e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi.”.
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**ANEKSI 1**  
**MBETJET E "LISTËS SË GJELBËR"**

Nr.	Kodet sipas Kat. Shqiptar te Mbetjeve	Kodet sipas Listes B te Konventes se Bazelit	Kodet sipas "Listes Gjelber"	Kodet Tarifore sipas NK 2012	Pershkrimi i mallit sipas Nomenklatures se Kombinuar te Mallrave 2012 (NK 2012)
1.	15 01 04	B 1010	GA 040	7204 10 00	Mbetje dhe kthime te gizes se derdhur;
2	16 01 17 17 04	B 1010	GA 050	7204 21	Mbetje dhe kthime te çeliqueve te lidhur: Prej çeliku te pandryshkshem;
3	02 01 10	B 1010	GA 070	7204 30 00	Mbetje dhe kthime te gizes dhe çelikut te kallajisur;
4		B 1010	GA 080	7204 41	Mbetje dhe kthime te tjera ferrike: Copa te vogla, ashkla, feta, mbetje bluarje, pluhur sharrimi dhe pluhur lemimi.
5	15 01 04	B 1010	GA 120	7404 00	Mbetjet dhe kthimet e bakrit;
6.	16 01 18	B 1010	GA 130	7503 00	Mbetje dhe kthime te nikelit;
7	1704	B 1010	GA 140	7602 00	Mbetje dhe kthime te aluminit;
8.	02 01 10	B 1020	GA 150	7802 00 00	Mbetje dhe kthime plumbi;
9		B 1010	GA 160	7902 00 00	Mbetje dhe kthime zinku;
10		B 1010	GA 170	8002 00 00	Mbetje dhe kthime kallaji;
11	10 50 01	B 1100	GB 010	2620 11 00	Zgjyrat: Qe permban kryesisht zink: Shufra te forta zinku;
12.	01 04 09	B 2020	GD 070	28 11 22	Dioksid silici ne forme te ngurte, duke perjashtuar ato te perdorura ne fonderi ( nese jane mbetje nga minierat );
13.	10 11 12 15 01 07 16 01 20 17 02 02	B 2020	GE 010	7001 00	Qelq i thyer dhe mbetje dhe mbeturina te tjera prej qelqi; qelq ne mase; (me perjashtim te qelqeve te tubave me rreze katodike dhe qelqeve te tjera te aktivizuara);
14.	10 11 03	B 2020	GE 020	7019 39	Fibra prej qelqi dhe artikuj prej tyre (mbetje)
15	15; 16; 17;	B 3010	GH 010	3915	Mbetjet, prerjet dhe kthimet, prej plastike: etilenit, stirenit, vinil kloridit, Prej plastikave te tjera
16	19; 20		GH 011	391510	
17			GH 012	391520	
18			GH 013	391530	
19.			GH 014	391590	
20	15; 19; 20	B 3020	GI 010	4707	Leter apo karton i rikuperueshem (mbetje dhe kthime): Prej letres apo kartonit te trashë te pazbardhur apo prej letres apokartonit te brimuar;
21			GI 011	4707 10 00	
22	15; 19; 20	B 3020	GI 012	4707 20 00	Leter apo karton i rikuperueshem (mbetje dhe kthime): Prej letres apo kartonit tjetër te bere kryesisht prej brumit kimik te zbardhur, jo te ngjyrosur ne mase;
23	15; 19; 20	B 3020	GI 013	4707 30	Leter apo karton i rikuperueshem (mbetje dhe kthime): Prej letres apo kartonit te bere kryesisht prej brumit mekanik: (psh, gazeta, revistat dhe materiale te ngjashme te shtypura);
24	04 20 01 10	B 3030	GJ 120	6309 00 00	Veshje te perdorura dhe artikuj te tjere veshje;
25.	15 01 03 17 02 01	B 3040	GL 010	4401 31 00	Tallash, mbetje dhe kthime te drurit, nese jane apo jo te aglomeruara ne kercunj, briketa, sfera apo ne forma te ngjashme: Sfera prej druri;

GA. Mbetje te metaleve dhe aliazheve te metaleve, ne trajte metalike jo te shperbere.

GB. Mbetje me permbajtje metal te dala nga shkrirja, ngurtesimi dhe rafinimi i metaleve.

GD. Mbetje nga operacionet ne miniera; Keto mbetje duhet te jene ne trajte jo te shperbere.

GE. Mbetje qelqi ne trajte jo te shperbere.

GH. Mbetje plastike te ngurta.

GI. Mbetje te letres, te kartonit dhe produkteve te letres.

GJ. Mbetje tekstile.

GL. Mbetje te patrajuara te tapes dhe drurit.

**VENDIM**

**Nr. 551, datë 22.8.2012**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN, REKRUTIMIN E  
TRAJNIMIN E PERSONELIT TË REGJISTRIMIT, SI DHE PËRCAKTIMIN E DETYRAVE  
E TË PËRGJEGJËSIVE TË PERSONELIT TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË  
NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 19, pikat 2 e 3, të ligjit nr. 10 201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen dhe rekrutimin e mbikëqyrësve, kontrollorëve, anketuesve, operatorëve e koordinatorëve dhe të specialistëve të financës në zyrat rajonale të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore, si dhe përcaktimin e përgjegjësive e të detyrave të tyre.

1.1 Përzgjedhja dhe rekrutimi i mbikëqyrësve bëhen sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) Të ketë arsimin e lartë universitar (profili bujqësor ose ekonomik përbëjnë avantazh);
- b) Të jetë banor i zonës, ku do të caktohet të punojë;
- c) Të njohë mirë territorin administrativ të rrethit, ku caktohet të punojë;
- ç) Të njohë zonën që do të mbulojë dhe të ketë aftësi të kuptojë dhe të orientohet me anë të hartave në terren;
- d) Të marrë pjesë në sesionet e trajnimeve dhe të ketë aftësi trajnimi dhe kontrolli për punën e kontrollorëve;
- dh) Të jetë i aftë fizikisht për lëvizje në distanca të gjata;
- e) Të jetë i gatshëm për punë me orare të zgjatura edhe gjatë ditëve të fundjavës apo ditëve të pushimit;
- ë) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe organizative;
- f) Të gëzojë reputacion të mirë në komunitet, si dhe të ketë figurë të pastër ligjore dhe shoqërore;
- g) Të mos jetë i angazhuar në ndonjë punë tjetër gjatë periudhës së regjistrimit;
- gj) Të ketë përvoja të ngjashme pune, përbën avantazh përvoja në fushën e vrojtimit statistikore;
- h) Të ketë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit në programet kompjuterike bazë të nevojshme dhe të përdorë internetin.

1.2 Përzgjedhja dhe rekrutimi i kontrollorëve bëhen sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) Të ketë arsimin e mesëm (arsimi i lartë universitar në profilin bujqësor ose ekonomik përbëjnë avantazh);
- b) Të jetë banor i bashkisë/komunës, ku ai do të caktohet të punojë;
- c) Të njohë zonën ku do të punojë dhe të ketë aftësi të kuptojë dhe të orientohet me anë të hartave në terren;
- ç) Të marrë pjesë në sesionet e trajnimeve dhe të ketë aftësi trajnuese e kontrolli për punën e anketuesve;
- d) Të jetë i aftë fizikisht për lëvizje në distanca të gjata;
- dh) Të jetë i gatshëm për të kryer kontrole në terren;
- e) Të jetë i gatshëm për punë me orare të zgjatura edhe gjatë ditëve të fundjavës apo ditëve të pushimit;



- ë) Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe organizative;
- f) Të gëzojë reputacion të mirë në komunitet dhe të ketë figurë të pastër ligjore dhe shoqërore;
- g) Të ketë përvoja të ngjashme pune, përbën avantazh përvoja në fushën e vrojtimeve statistikore;
- gj) Të mos jetë i angazhuar në ndonjë punë tjetër gjatë periudhës së regjistrimit;
- h) Të ketë njohuri në përdorimin e kompjuterit në programet kompjuterike bazë të nevojshme dhe të përdorë internetin.

#### 1.3 Përzgjedhja dhe rekrutimi i anketuesve bëhen sipas kritereve të mëposhtme:

- a) Të ketë arsimin e mesëm (profili bujqësor ose ekonomik ose arsimit i lartë, si dhe disa njohuri në statistikë përbëjnë avantazh);
- b) Të jetë banor i qytetit/fshatit, ku do të kryhet regjistrimi;
- c) Të njohë mirë terrenin ku do të kryhet regjistrimi;
- ç) Të jetë i aftë fizikisht dhe i gatshëm për lëvizje në distanca të gjata;
- d) Të jetë i aftë të punojë në mënyrë të pavarur;
- dh) Të jetë i aftë të punojë me orë fleksibël dhe gjatë fundjavës;
- e) Të kuptojë dhe të zbatojë udhëzimet me shkrim dhe ato verbale;
- ë) Të ketë aftësi të kuptojë dhe të orientohet me anë të hartave në terren;
- f) Të shkruajë pastër dhe qartë;
- g) Të jetë i mirorganizuar dhe të ketë aftësi të mira komunikuese;
- gj) Të gëzojë reputacion të mirë në komunitet dhe të ketë figurë të pastër ligjore dhe shoqërore;
- h) Të ketë përvoja të ngjashme pune, përbën avantazh përvoja në fushën e vrojtimeve statistikore;
- i) Të vishet në mënyrë të përshtatshme gjatë kohës së punës;
- j) Të jetë i sjellshëm, i durueshëm dhe i besueshëm në komunikim.

#### 1.4 Përzgjedhja dhe rekrutimi i operatorëve bëhen sipas kritereve të mëposhtme:

- a) Të jetë banor i qytetit të Tiranës;
- b) Të jetë në moshën 18-50 vjeç;
- c) Të ketë përfunduar arsimin e mesëm (arsimi i lartë përbën avantazh);
- ç) Të ketë njohuri bazë të përdorimit të kompjuterit në programet kompjuterike bazë të nevojshme;
- d) Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- dh) Përvoja të ngjashme pune përbëjnë avantazh.

#### 1.5 Përzgjedhja dhe rekrutimi i koordinatorëve në zyrat rajonale të regjistrimit bëhen sipas kritereve të mëposhtme:

- a) Të ketë përfunduar arsimin e lartë;
- b) Të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet;
- c) Të jetë banor i rrethit qendër qarku ku ai aplikon;
- ç) Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe aftësi për të punuar në grup;
- d) Të ketë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit në programet kompjuterike bazë të nevojshme;
- dh) Të ketë njohuri të mira në të shkruar dhe në të folur të gjuhës angleze.

#### 1.6 Përzgjedhja dhe rekrutimi i specialistëve të financës në zyrat rajonale të regjistrimit bëhen sipas kritereve të mëposhtme:

- a) Të ketë diplomë universitare të Fakultetit Ekonomik (dega “Financë”);
- b) Të ketë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit në programet kompjuterike bazë të nevojshme, si dhe në programet kompjuterike për analizat e kontabilitetit financiar;

- c) Të ketë njohuri të gjuhës angleze;
- ç) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune;
- d) Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe aftësi për të punuar në grup.

2. Përgjegjësitë dhe detyrat e mbikëqyrësve, kontrollorëve, anketuesve, operatorëve, si dhe të koordinatorëve e të specialistëve të financës në zyrat rajonale të regjistrimit janë si më poshtë vijon:

#### 2.1 Përgjegjësitë dhe detyrat e mbikëqyrësit

Mbikëqyrësi është përgjegjësi kryesor për zbatimin e kriterëve metodologjike të përcaktuara për zbatim gjatë regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore. Mbikëqyrësi kryen detyrat e mëposhtme:

a) Merr pjesë në trajnimin e mbikëqyrësve të organizuar në kuadrin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;

b) Mbikëqyr dhe monitoron zhvillimin e aktiviteteve të regjistrimit në territorin e caktuar, duke përdorur funksionet specifike të dhëna nga faqja web GIS, e krijuar nga INSTAT-i për regjistrimin e njësive ekonomike bujqësore për të mbështetur këtë detyrë.

c) Siguron koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit të caktuar të kontrollorëve dhe u siguron atyre asistencë teknike sipas nevojave të kërkuara;

ç) Bashkëpunon me zyrën e statistikës në rreth dhe stafin e INSTAT-it dhe zbaton urdhrat dhe udhëzimet e tyre;

d) Organizon mbledhje me çdo kontrollor, të paktën një herë në javë;

dh) I raporton përgjegjësit të zyrës së statistikës në rreth për çdo problem serioz të hasur gjatë aktiviteteve të regjistrimit në territorin e caktuar;

e) Merr në dorëzim dhe dorëzon dokumentacionin përkatës të regjistrimit të dokumentuar sipas procedurës dhe procesverbaleve përkatëse, të miratuara nga INSTAT-i;

ë) Bazuar në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikën zyrtare”, zbaton rregullat për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tij;

f) Ruan karakterin konfidencial të informacionit dhe të të dhënave të regjistrimit, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij, si dhe në asnjë rast e në asnjë rrethanë nuk i zbulon këto të dhëna dhe informacionin, me përjashtim të personave të përfshirë në regjistrim dhe që kontrollojnë dhe monitorojnë punën e tij;

g) Merr pjesë në trajnim dhe ndihmon trajnuesit, si dhe realizon trajnimin e anketuesve;

gj) Mban me vete gjatë aktiviteteve të regjistrimit, autorizimin dhe kartën identifikuese për të vërtetuar funksionin që kryen;

h) Realizon të gjitha detyrat e tjera sipas manualit të mbikëqyrësit, të hartuar nga INSTAT-i;

i) Zbaton të gjitha urdhrat dhe udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin.

#### 2.2 Përgjegjësitë dhe detyrat e kontrollorit

Kontrollori është përgjegjës për respektimin e procedurës së regjistrimit, organizimin dhe drejtimin e punës, si dhe mbarëvajtjen e punës në terren. Ai përgjigjet për mbulimin e anketimit dhe cilësinë e të dhënave të grumbulluara, për shpërndarjen dhe grumbullimin e të gjitha materialeve dokumentare të regjistrimit për anketuesit që mbulon sipas dokumentacionit të përgatitur nga INSTAT-i për këtë qëllim. Kontrollori kryen detyrat e mëposhtme:

a) Merr pjesë në trajnimin e kontrollorëve të organizuar në kuadrin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;

b) Kryen trajnimin e anketuesve në bashkëpunim me mbikëqyrësin në bazë të udhëzimeve metodologjike, të miratuara nga INSTAT-i, pas trajnimit që ka kaluar edhe ai vetë;

c) Organizon dhe ndjek gjithë punën e anketuesve në terren, sipas detyrave dhe afateve të anketimit, të caktuara për çdo anketues sipas kalendarit të miratuar nga INSTAT-i;

ç) Bashkëpunon me mbikëqyrësin dhe stafin e INSTAT-it në nivel qendror dhe vendor, duke ndjekur këshillat dhe duke zbatuar udhëzimet e tyre;



d) Takon rregullisht mbikëqyrësin, të paktën dy herë në javë, dhe e informon sa më shpejt të jetë e mundur atë për vështirësitë dhe problemet serioze që nuk mund t'i zgjidhë vetë;

dh) Siguron koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit të anketuesve dhe u siguron atyre asistencë teknike sipas nevojës;

e) Kontrollon cilësinë e të dhënave të pyetësorëve të plotësuar mbi bazën e kriterëve metodologjike dhe planit të kontrollit që i është dhënë;

ë) Vepron si anketues për institucionet publike dhe entet fetare në një territor të caktuar, në bashkëpunim me zyrën statistikore të rrethit të INSTAT-it;

f) Plotëson formularët përmbledhës dhe raporte të tjera informative lidhur me regjistrimin për zonën që mbulon;

g) Merr në dorëzim dhe dorëzon dokumentacionin përkatës të regjistrimit të dokumentuar sipas procedurës dhe dokumentacionit të hartuar nga INSTAT-i;

gj) Bazuar në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", zbaton rregullat e konfidencialitetit të të dhënave, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tij;

h) Ruan karakterin konfidencial të informacionit dhe të të dhënave të lidhura me regjistrimin, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij, si dhe në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk zbulon këto të dhëna dhe informacionin, me përjashtim të personave që kontrollojnë dhe monitorojnë punën e tij;

i) Mban me vete gjatë aktiviteteve të regjistrimit autorizimin dhe kartën identifikuese për të vërtetuar funksionin që kryen;

j) Realizon të gjitha detyrat e tjera sipas manualit të kontrollorit të hartuar nga INSTAT-i;

k) Zbaton të gjitha urdhrat dhe udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin.

### 2.3 Përgjegjësitë dhe detyrat e anketuesit

Anketuesi është personi përgjegjës për kontaktimin dhe intervistimin e subjekteve të përfshira në fushën e zbatimit të regjistrimit sipas pyetësorit të regjistrimit. Ai duhet të tregohet i përmbajtur dhe profesional gjatë intervistimit të subjekteve të përfshira në fushën e zbatimit të regjistrimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e anketuesit nuk mund t'u transferohen personave të tretë. Anketuesi kryen detyrat e mëposhtme:

a) Merr pjesë në trajnimin e organizuar në kuadër të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;

b) Raporton, sipas mënyrës së përcaktuar, pranë kontrollorit dhe INSTAT-it për ecurinë ditore të regjistrimit në zonën që i caktohet;

c) Interviston subjektet e përfshira në fushën e zbatimit të regjistrimit në të gjithë zonën që i është caktuar;

ç) Informon që në fillim të intervistës subjektin që intervistohet se informacioni i dhënë prej tij gjatë regjistrimit është krejtësisht konfidencial dhe publikohet vetëm në mënyrë të përmbledhur e vetëm për qëllime statistikore;

d) Bazuar në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", zbaton rregullat e konfidencialitetit të të dhënave, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tij;

dh) Ruan karakterin konfidencial të informacionit dhe të të dhënave të mbledhura prej tij gjatë regjistrimit, si dhe në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk zbulon këto të dhëna e informacionin, me përjashtim të personave, të cilët kontrollojnë dhe monitorojnë punën e tij;

e) Zbaton udhëzimet e paraintervistës dhe në veçanti duhet të jetë i sigurt se po plotëson pyetësorin vetëm pasi të ketë vërtetuar se njësia është një "njësi ekonomike bujqësore", siç përcaktohet për regjistrimin;

ë) I raporton kontrollorit për të gjitha rastet kur një person refuzon të intervistohet ose krijon pengesa për plotësimin e pyetësorit;



f) Kryen të gjitha detyrat e specifikuar nga kontrollori, supervizori dhe nëpunësit e INSTAT-it;

g) Mban me vete autorizimin dhe kartën identifikuese për të vërtetuar funksionin që kryen;

gj) Mban të gjitha materialet e nevojshme në çantën e regjistrimit dhe merr masa që pyetësorët dhe formularët të mos dëmtohen apo humbin;

h) Kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara në manualin e anketuesit, të hartuar nga INSTAT-i;

i) Zbaton të gjitha urdhrat dhe udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin.

#### 2.4 Përgjegjësitë dhe detyrat e operatorit

Operatori është personi përgjegjës për hedhjen e të dhënave të mbledhura nga regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore në bazën e të dhënave të krijuara për qëllim të regjistrimit nga INSTAT-i. Operatori kryen detyrat e mëposhtme:

a) Hedh të dhënat e mbledhura nëpërmjet pyetësorëve të regjistrimit në bazën e të dhënave, të krijuar nga INSTAT-i, për qëllim të regjistrimit;

b) Hedh të dhënat në mënyrë të saktë dhe pa gabime sipas udhëzimeve të INSTAT-it;

c) Bazuar në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, zbaton rregullat e konfidencialitetit të të dhënave për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tij;

ç) Ruan karakterin konfidencial të informacionit dhe të të dhënave të lidhura me regjistrimin, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij, si dhe në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk u zbulon këto të dhëna e informacion personave të tjerë;

d) Zbaton të gjitha urdhrat dhe udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin.

2.5 Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit dhe specialistit të financës në zyrat rajonale të regjistrimit.

2.5.1 Koordinatori është pozicion shumë i rëndësishëm në strukturën e regjistrimit. Ai do të jetë:

- një menaxher i operacioneve në nivel rajonal. Ky pozicion menaxherial rezulton të jetë i nevojshëm në sigurimin se janë plotësuar objektivat e procesit të regjistrimit;

- një mbështetje për komisionet e regjistrimit në qark, bashki dhe komuna, si gjatë punës përgatitore, ashtu edhe në fazën e numërimit dhe pas procesit të numërimit.

Koordinatori kryen detyrat e mëposhtme:

a) Mbështet komisionet e regjistrimit në qark, bashki dhe komuna;

b) Koordinon rrjedhën ditore të punës me stafin në terren;

c) Organizon punën në bashkëpunim me mbikëqyrësit gjatë të gjitha fazave të regjistrimit;

ç) Siguron komunikimin ndërmjet stafit në terren dhe komisioneve të regjistrimit në qark dhe bashki e komuna;

d) Siguron të gjithë mbështetjen logjistike të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të regjistrimit sipas të gjitha fazave të tij;

dh) Monitoron punën e vetë zyrave rajonale të regjistrimit;

e) Monitoron çdo ditë aktivitetin e mbikëqyrësve gjatë fazës operative;

ë) Siguron zgjidhje për probleme të ndryshme, si gjatë punës përgatitore, fazës operative dhe pas procesit të numërimit;

f) Kontrollon që aktivitetet dhe të gjitha fazat e regjistrimit janë kryer në përputhje me planin e punës, të hartuar nga INSTAT-i;

g) I raporton menaxherit të projektit;

gj) Zbaton të gjithë urdhrat dhe udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin.

2.5.2 Specialisti i financës kujdeset për ekzekutimin e fondeve të akorduara nga Buxheti i Shtetit dhe donatorët, si dhe për administrimin e kontratave që do të nënshkruhen gjatë procesit të regjistrimit. Specialisti i financës në zyrat rajonale të regjistrimit kryen detyrat e mëposhtme:



a) Administron dhe plotëson dokumentacionin shoqërues të kontratave të punës për stafin në terren, në nivel qarku;

b) Bën pagesa dhe përmbush kërkesat në kohë;

c) Mban kontakte të vazhdueshme me sektorin e financës në INSTAT;

ç) Respekton pagesën në kohë të stafit në terren në bazë të kontratave;

d) Kryen detyra të tjera sipas kërkesave të INSTAT-it;

dh) Zbaton të gjithë urdhrat dhe udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin.

2.6 Rekrutimi i mbikëqyrësve, kontrollorëve, anketuesve, operatorëve, koordinatorëve dhe specialistëve të financës në zyrat rajonale të regjistrimit

2.6.1 Rekrutimi i mbikëqyrësve kryhet në 3 (tri) faza:

- Faza e parë: Hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët;

- Faza e dytë: Intervistimi me gojë/testimi me shkrim i kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë;

- Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve, dërgimi i kësaj liste INSTAT-it dhe emërimi i mbikëqyrësve.

Faza e parë: Pranimi i aplikimeve në INSTAT për pozicionin e mbikëqyrësit brenda afateve të përcaktuara në njoftimet e publikuara nga INSTAT-i. Shqyrtimi i dokumentacionit për çdo aplikim dhe hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga INSTAT-i, në bashkëpunim me komisionin e regjistrimit në qark, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

Faza e dytë: Zhvillimi, sipas rastit, i intervistimit me gojë ose testimit me shkrim të kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë nga INSTAT-i, në bashkëpunim me komisionin e regjistrimit në qark.

Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve në bazë të rezultateve të intervistimit me gojë ose testimit me shkrim nga komisioni i regjistrimit në qark në bashkëpunim me INSTAT-in. Komisioni i regjistrimit në qark i dërgon INSTAT-it një kopje të listës përfundimtare të fituesve përpara fillimit të procesit të trajnimit të mbikëqyrësve. Emërimi i mbikëqyrësve bëhet nga INSTAT-i.

2.6.2 Rekrutimi i kontrollorëve kryhet në 4 (katër) faza:

- Faza e parë: Hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët;

- Faza e dytë: Dërgimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur në komisionin e regjistrimit në qark;

- Faza e tretë: Intervistimi me gojë/testimi me shkrim i kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë.

- Faza e katërt: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve, dërgimi i kësaj liste INSTAT-it dhe emërimi i kontrollorëve.

Faza e parë: Pranimi i aplikimeve në komisionet e regjistrimit në bashki dhe komunë për pozicionin e kontrollorit brenda afateve të përcaktuara në njoftimet e publikuara nga INSTAT-i. Shqyrtimi i dokumentacionit për çdo aplikim dhe hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim nga komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë, në bashkëpunim dhe sipas udhëzimeve të INSTAT-it.

Faza e dytë: Komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë i dërgon komisionit të regjistrimit në qark listën e shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë.

Faza e tretë: Komisioni i regjistrimit në qark, në bashkëpunim me INSTAT-in zhvillon, sipas rastit, intervistimin me gojë ose testimin me shkrim të kandidatëve sipas listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë.

Faza e katërt: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve në bazë të rezultateve të intervistimit

me gojë ose testimi me shkrim nga komisioni i regjistrimit në qark në bashkëpunim me INSTAT-in. Komisioni i regjistrimit në qark i dërgon INSTAT-it një kopje të listës përfundimtare të fituesve përpara fillimit të procesit të trajnimit të kontrollorëve. Emërimi i kontrollorëve bëhet nga INSTAT-i.

#### 2.6.3 Rekrutimi i anketuesve kryhet në 3 (tri) faza:

- Faza e parë: Hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët;

- Faza e dytë: Intervistimi me gojë/testimi me shkrim i kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë.

- Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve dhe dërgimi i kësaj liste INSTAT-it.

Faza e parë: Pranimi i aplikimeve në komisionet e regjistrimit në bashki dhe komunë për pozicionin e anketuesit brenda afateve të përcaktuara në njoftimet e publikuara nga INSTAT-i. Shqyrtimi i dokumentacionit për çdo aplikim dhe hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë, në bashkëpunim me INSTAT-in, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

Faza e dytë: Zhvillimi, sipas rastit, i intervistimit me gojë ose testimin me shkrim të kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë nga komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë, në bashkëpunim dhe sipas udhëzimeve të INSTAT-it.

Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve në bazë të rezultateve të intervistimit me gojë ose testimi me shkrim nga komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë, në bashkëpunim me INSTAT-in. Komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë i dërgon INSTAT-it një kopje të listës përfundimtare të fituesve, së bashku me një informacion të hollësishëm për çdo fitues me të dhënat individuale të mëposhtme:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin;

b) vendin dhe datën e lindjes;

c) arsimin përkatës;

ç) numrin e dokumentit identifikues.

Komisioni i regjistrimit në bashki dhe komunë duhet t'i dërgojë INSTAT-it listën dhe informacionin e përmendur në paragrafin e mësipërm, përpara fillimit të procesit të trajnimit të anketuesve.

#### 2.6.4 Rekrutimi i operatorëve kryhet në 3 (tri) faza:

- Faza e parë: Hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët;

- Faza e dytë: Intervistimi me gojë/testimi i kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë.

- Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve dhe emërimi.

Faza e parë: Pranimi i aplikimeve në INSTAT për pozicionin e operatorit brenda afateve të përcaktuara në njoftimet e publikuara nga INSTAT-i. Shqyrtimi i dokumentacionit për çdo aplikim dhe hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve, të përzgjedhur nga INSTAT-i, sipas kriterëve të miratuara në këtë vendim.

Faza e dytë: Zhvillimi, sipas rastit, i intervistimit me gojë ose testimi të kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë nga INSTAT-i.

Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve në bazë të rezultateve të intervistimit me gojë ose testimi me shkrim dhe emërimi i tyre nga INSTAT-i.

2.6.5 Rekrutimi i koordinatorëve dhe specialistëve të financës për zyrat rajonale të regjistrimit kryhet në 3 (tri) faza:

- Faza e parë: Hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve të përzgjedhur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët;

- Faza e dytë: Intervistimi me gojë/testimi me shkrim i kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë.

- Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve dhe emërimi.



Faza e parë: Pranimi i aplikimeve në INSTAT për pozicionet e koordinatorëve dhe specialistëve të financës brenda afateve të përcaktuara në njoftimet e publikuara nga INSTAT-i. Shqyrtimi i dokumentacionit për çdo aplikim dhe hartimi i listës së shkurtuar të kandidatëve, të përzgjedhur nga INSTAT-i, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

Faza e dytë: Zhvillimi, sipas rastit, i intervistimit me gojë ose testimi me shkrim të kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë nga INSTAT-i.

Faza e tretë: Hartimi i listës përfundimtare të fituesve në bazë të rezultateve të intervistimit me gojë ose testimi me shkrim, si dhe emërimi i tyre nga INSTAT-i.

#### 2.7 Trajnimi i mbikëqyrësve, koordinatorëve, kontrollorëve dhe anketuesve

2.7.1 Mbikëqyrësit, koordinatorët, kontrollorët dhe anketuesit u nënshtrohen trajnimit sipas programit të trajnimit, të hartuar nga INSTAT-i. INSTAT-i mund të përcaktojë kategori të tjera të personelit të regjistrimit, të cilat mund të përfshihen në procesin e trajnimit. Programi i trajnimit përbëhet nga dy pjesë, pjesa e përgjithshme (A) dhe pjesa e veçantë (B).

Pjesa e përgjithshme (A) përmban materialin e trajnimit për mbikëqyrësit, koordinatorët, kontrollorët dhe anketuesit, që do të merret me regjistrimin, ku përfshihen:

a) njohuritë për qëllimin dhe objektin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore, përkufizimet dhe konceptet, bazën ligjore, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

b) njohuritë për pyetësin dhe pjesët përbërëse të tij, manualët e përdorimit, klasifikimet, teknologjinë e informacionit që do të përdoret dhe sistemet e hartografisë;

c) njohuri të tjera, përveç atyre të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, që janë të nevojshme dhe të rëndësishme për personelin e regjistrimit për të kuptuar dhe për të kryer regjistrimin.

Pjesa e veçantë (B) përmban materialin e trajnimit për çdo kategori të veçantë të personelit që do të merret me regjistrimin dhe konkretisht:

a) Për mbikëqyrësit dhe koordinatorët, materiali i trajnimit përmban mënyrën e organizimit të punës në terren, çështjet e logjistikës, mënyrat e shpërndarjes e të grumbullimit të pyetësorëve, si dhe mënyrat e organizimit e të monitorimit të punës së kontrollorëve, mënyrat e raportimit në Institutin e Statistikave;

b) Për kontrollorët, materiali i trajnimit përmban mënyrën e punës në terren, çështjet e logjistikës, metodat e shpërndarjes e të grumbullimit të të dhënave, metodat e monitorimit e të kontrollit të cilësisë së punës së anketuesve, mënyrat e raportimit, si dhe detyrat e kontrollorit ndaj mbikëqyrësit;

c) Për anketuesin, materiali i trajnimit përqendrohet në njohjen e hollësishme të përmbajtjes së pyetësit, mënyrat e plotësimit të tij gjatë intervistimit, mënyrat e raportimit, si dhe detyrat e anketuesit ndaj kontrollorit dhe Institutit të Statistikave.

#### 2.7.2 Trajnimi kryhet në nivel rrethi dhe do të ketë këtë kohëzgjatje:

- Për mbikëqyrësit dhe koordinatorët, jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë;

- Për kontrollorët, jo më shumë se 5 (pesë) ditë;

- Për anketuesit, jo më shumë se 5 (pesë) ditë.

2.7.3 Trajnimi i mbikëqyrësve, koordinatorëve, kontrollorëve dhe anketuesve përfundon jo më vonë se 2 (dy) ditë para datës së përcaktuar për fillimin e regjistrimit.

2.7.4 INSTAT-i cakton trajnerët përkatës, që do të kryejnë trajnimin e mbikëqyrësve, koordinatorëve, kontrollorëve dhe anketuesve.

3. Ngarkohen komisionet e regjistrimit në qark, komisionet e regjistrimit në bashki e komuna, si dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 552, datë 22.8.2012**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.3.2010 PËR ÇËSHTJEN NR. 6397/04 “BUSHATI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 19.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.3.2010 për çështjen nr. 6397/04 “Bushati dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në shumën 11 500 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro, si dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, znj. Ixhlale Bushati, z. Skënder Bushati e z. Genc Bushati dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

5. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesve, znj. Ixhlale Bushati, z. Skënder Bushati dhe z. Genc Bushati, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 553, datë 22.8.2012**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT TË INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “EPOKA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 43 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “Epoka” nga shkollë e lartë në universiteti privat “Epoka”.
  2. Ky institucion privat i arsimit të lartë ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
  3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 554, datë 22.8.2012

**PËR DHËNIE LICENCE PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “QENDRA AKADEMIKE E LEZHËS”  
(LEZHA ACADEMIC CENTER)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për hapjen, në qytetin e Lezhës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Qendra Akadematike e Lezhës”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj dhe do të administrohet nga fondacioni “Albanian Mennonite Education” (Arsimi Menonit Shqiptar).
  2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore, nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 555, datë 22.8.2012

**PËR DHËNIE LICENCE PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “SHKOLLA NDËRKOMBËTARE E  
SHQIPËRISË” (ALBANIAN INTERNATIONAL SCHOOL), TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Shkolla Ndërkombëtare e Shqipërisë” (Albanian International School), që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj dhe do të administrohet nga “Albanian International School” sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 556, datë 22.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 129, DATË 22.2.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR, UNAZA E MADHE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 129, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shuma e palikuiduar prej 88 257 933 (tetëdhjetë e tetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e shtatëdhjetë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesëdhjetë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



**VENDIM**

**Nr. 557, datë 22.8.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 133, DATË 22.2.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA  
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QUKËS QAFËPËLLOÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 5 e vendimit nr. 133, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shuma e palikuiduar prej 4 001 150.5 (katër milionë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë pikë pesë) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 558, datë 22.8.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 334, DATË 16.5.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR SHKOZET-DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 3 e vendimit nr. 334, datë 16.5.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Shuma e palikuiduar prej 640 800 (gjashtëqind e dyzet mijë e tetëqind) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 8 532 000 (tetë milionë e pesëqind e tridhjetë e dymijë) lekësh,



do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

**VENDIM**

**Nr. 559, datë 22.8.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 130, DATË 22.2.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR MAMINAS-GJIRI I LALZIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 5 e vendimit nr. 130, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shuma e palikuiduar prej 43 733 209 (dyzet e tre milionë e shtatëqind e tridhjetë e tremijë e dyqind e nëntë) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 43 865 699 (dyzet e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

**VENDIM**

**Nr. 560, datë 22.8.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 563, DATË 3.8.2011 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 138, DATË 23.3.2000 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET TEKNIKE TË VLERËSIMIT DHE  
PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PASURIVE QË SHPRONËSOHEN,  
TË PASURIVE QË ZHVLERËSOHEN, DHE TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË  
TRETË, PËR INTERES PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në paragrafin e fundit të vendimit nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 31.6.2012.” ndryshohen me “... dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 1.5.2013.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 561, datë 22.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 131, DATË 22.2.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA  
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, UNAZA LINDORE SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 131, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shuma e palikuiduar prej 83 247 670 (tetëdhjetë e tre milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 104 369 670 (njëqind e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**

**Nr. 562, datë 22.8.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 132, DATË 22.2.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (KULTURA BUJQËSORE DHE  
DRUFRUTORË), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN –  
VLORË (SEKSIONI I PARË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 5 e vendimit nr. 132, datë 22.2.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shuma e palikuiduar prej 6 336 392 (gjashtë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 6 398 024 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 563, datë 22.8.2012**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË  
KOMUNËS POSHNJË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Poshnjë të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 517 (pesëqind e shtatëmbëdhjetë).



2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Poshnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

Komuna Poshnjë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
9, 10, 11, 15-17, 39, 46	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
27-36	Varrezat publike	Në pronësi
38, 41, 47-57, 61-63, 66-74, 81	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
40, 58, 59	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
83-85	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
86-89, 91-96	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
117-128	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
450-490	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) Sip. 2,55 ha, zona kadastrale 1935 në fshatin Hingë; sip. 8.39 ha, zona kadastrale 2301 në fshatin Kuç dhe sip. 18.95 ha, zona kadastrale 1004 në fshatin Agim: i janë dorëzuar AKKP-së.	Në përdorim
491-504	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të trata dhe toka joproduktive)	Në pronësi

## VENDIM

Nr. 608, datë 5.9.2012

### **PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT TË PRONËSISË TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË NDËRTUARA DERI MË 10.8.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE, SI DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç” të nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të nenit 74 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i institucionit të autorizuar dhe i procedurës së kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, në rastet kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë, në kuptim të nenit 193 të Kodit Civil, me qëllim regjistrimin fillestar apo regjistrimin e tyre në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme me titull të qartë të pronësisë.

6892

2. Institucionet e përfshira në procesin e kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, sipas këtij vendimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga:

- a) parimi i ligjshmërisë;
- b) parimi i sigurisë juridike;
- c) parimi i transparencës;
- ç) parimi i barazisë para ligjit;
- d) parimi i subsidiaritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror për

zgjidhjen e problemeve të përbashkëta;

dh) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në përgjithësi, dhe i së drejtës së pronës, në veçanti.

3. Institucioni i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, dhe të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, është bashkia ose komuna, ku gjendet pasuria e paluajtshme. Institucioni i autorizuar vepron gjatë procedurave të regjistrimit fillestar me kërkesë të regjistruarit apo të një personi ose të çdo grupi të ngarkuar nga kryeregjistruari apo me kërkesë të individit (kërkuesi), sipas nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

4. Institucioni i autorizuar ngarkohet të kryejë procedurën paraprake për kalimin në pronësi të ndërtimeve, të pasurive të paluajtshme e të truallit funksional të tyre, subjekteve që plotësojnë kushtet e përcaktuara, si më poshtë vijon:

a) Objektivit të ndërtuar t'i ketë përfunduar karabinaja dhe mbulesa deri më 10.8.1991;

b) Trualli funksional duhet të rezultojë fizikisht i lirë dhe i pazënë nga ndërtime pa leje, të cilat janë objekt i ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Madhësia e sipërfaqes së truallit funksional në posedim të përfituesit të jetë ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993 “Për urbanistikën”.

c) Në rastet kur madhësia e sipërfaqes së truallit funksional në posedim të përfituesit është më e madhe se ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993 “Për urbanistikën”, ajo sipërfaqe kalon në pronësi nga shteti tek individit sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

ç) Objekti, trualli nën të dhe trualli funksional, të mos jenë të regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme apo edhe kur janë të regjistruar, mungon akti i fitimit të pronësisë;

d) Objekti i ndërtuar dhe trualli funksional janë të patrajtuar nga legjislacioni përkatës për njohjen, kthimin e kompensimin e pronës apo për legalizimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje.

5. Regjistrimi fillestar bëhet në mënyrë sistematike nga regjistruari, një person ose grup personash të ngarkuar nga kryeregjistruari apo me kërkesë të individit. Nëse bëhet me kërkesë të individit, në zonat ku ka përfunduar regjistrimi fillestar, ajo depozitohet tek institucioni i autorizuar, e shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin e lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), që vërteton se pasuria nuk është e regjistruar në regjistrin publik apo është regjistruar dhe i mungon akti i fitimit të pronësisë;

b) Planin e rievimit të pasurisë, të përgatitur nga një subjekt i licencuar për punime topografike;

c) Vërtetimin e lëshuar nga ZVRPP-ja se për këtë pasuri të paluajtshme nuk ka pasur kërkesë për regjistrim nga ndonjë subjekt tjetër;

ç) Dokumentin zyrtar, të lëshuar nga organet e pushtetit vendor brenda kompetencave të tyre, që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991.

6. Shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit nga institucioni i autorizuar kryhet sipas kësaj procedure:

a) Institucioni i autorizuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës



dhe të dokumenteve provuese, kryen verifikimin nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi.

b) Verifikimi i kushteve bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e tij, si dhe nga marrja e informacionit zyrtar nga institucionet shtetërore. Në çdo rast, institucioni i autorizuar kërkon detyrimisht informacion zyrtar pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ALUIZNI-t, Zyrës së Gjendjes Civile dhe çdo organi shtetëror që administron të dhëna për pasurinë e paluajtshme dhe për vërtetimin e gjendjes familjare të poseduesit të pasurisë së paluajtshme përpara datës 10.8.1991. Korrespondenca bëhet pjesë e dosjes. Çdo institucion shtetëror është i detyruar të kthejë përgjigje me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Në rast të moskthimit të përgjigjes brenda këtij afati, drejtuesi i institucionit të autorizuar njofton me shkrim Ministrin e Drejtësisë, Ministrin e Brendshëm dhe kabinetin e Kryeministrit.

c) Institucioni i autorizuar ka detyrë të kryejë saktësimin e kufijve të sipërfaqes që kërkohet të tjetërsohet, duke kryer matje në terren, kur rezulton se dokumentacioni tekniko-ligjor i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban kufij ose dokumentacioni teknik nuk është i plotë. Shpenzimet e verifikimit dhe të matjes në terren paguhet nga përfituesi dhe janë pjesë e tarifës së shërbimit.

ç) Institucioni i autorizuar përgatit relacionin teknik, i cili përmban përshkrimin e hollësishëm për verifikimin e kryer dhe përgjigjen e specifikuar për secilin nga kushtet përkatëse, të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi. Relacioni përmban të dhënat e sakta për sipërfaqen që kërkohet të tjetërsohet, me planvendosjen e saj për sipërfaqen në metra katrorë. Relacioni teknik mbyllet me përfundimet e paraqitura për përmbushjen ose jo të kushteve të pasurisë së paluajtshme, nëpërmjet arsyetimit të veçantë të secilit prej tyre, duke u shprehur edhe për përbërjen familjare të përfituesit dhe vendbanimit të tij deri në datën 10.8.1991.

d) Institucioni i autorizuar, në përfundim të shqyrtimit, sipas afatit të përcaktuar në shkronjën "a", afishon menjëherë në institucionin e autorizuar dhe në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të dhënat për kërkesën e paraqitur brenda një afati prej 45 (dyzet e pesë) ditësh. Nëse gjatë periudhës së afishimit paraqitet ankesë apo pretendim për pronën, i shoqëruar me dokumente ligjore për pasurinë e paluajtshme të afishuar, i cili gjendet i bazuar nga institucioni i autorizuar, atëherë ai merr vendim për mospranimin e kërkesës, pas shqyrtimit të akteve të paraqitura nga ankuesi. Nëse brenda periudhës së afishimit nuk paraqitet ndonjë ankesë apo pretendim për pasurinë e paluajtshme, institucioni i autorizuar merr vendim për pranimin e kërkesës. Vendimi bëhet sipas aneksit nr. 1 të këtij vendimi. Institucioni i autorizuar i përcjell këshillit respektiv të qarkut vendimin, dosjen e plotë së bashku me relacionin teknik, të shoqëruar me inventarin e dokumenteve, si dhe njofton kërkuesin, sipas rastit, për përmbushjen e kritereve të përcaktuara, duke dhënë një përshkrim të hollësishëm të sipërfaqes, së bashku me planimetrinë ose mospërmbushjen e kritereve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, të përshkruara në mënyrë të hollësishme.

7. Këshilli i qarkut shprehet me vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së dosjes së plotë së bashku me relacionin teknik. Nëse këshilli i qarkut nuk shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve, kalimi i pronësisë quhet i miratuar. Kur këshilli i qarkut refuzon vendimin e institucionit të autorizuar, ai arsyeton në mënyrë të hollësishme shkaqet e refuzimit.

8. Institucioni i autorizuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i këshillit të qarkut, bën kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme e të truallit funksional të tyre në emër të personave, sipas përbërjes familjare që figuron në certifikatën familjare deri më 10.8.1991, dhe e dërgon vendimin për regjistrim në ZVRPP-në kërkuese. Vendimit i bashkëlidhet kopja e njëzuar e dosjes me dokumentacionin e plotë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi verifikon vetëm elementet formale të vendimit të paraqitur për regjistrim nga institucioni i autorizuar, procedon brenda 10

(dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit. Kur regjistrimi fillestar nuk po kryhet nga vetë ZRPP-ja, kjo e fundit brenda 5 (pesë) ditëve, vë aktet në dispozicion të subjekteve të kontraktuara për të kryer procedurat e regjistrimit fillestar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

10. Përfituesi i pasurisë së paluajtshme, në kohën e marrjes së certifikatës së pronësisë, paguan në numrin e llogarisë së caktuar nga institucioni i autorizuar tarifën e shërbimit. Masa e tarifës së shërbimit caktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm.

11. Nëse Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjatë verifikimit formal konstaton praktika abuzive apo korruptive të institucionit të autorizuar, paraqet menjëherë kallëzim në prokurorinë kompetente.

12. Institucioni i autorizuar, këshilli i qarkut dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për qëllime transparence, publikojnë në faqet zyrtare të internetit, si dhe në mjediset e njoftimeve publike çdo vendim të marrë përgjatë kësaj procedure.

13. Çdo mosmarrëveshje që lind gjatë zbatimit të këtij vendimi, ankimohet në gjykatë sipas ligjit.

14. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, në bashkëpunim me mjetet e informimit të gjerë publik në nivel kombëtar, kryen fushatën kombëtare të informimit dhe të sensibilizimit të qytetarëve. ZQRPP-ja merr masat për ngritjen e bazës së të dhënave për informatizimin e të dhënave të administruara gjatë këtij procesi, si dhe publikimin e informacioneve lidhur me këtë proces në faqen e saj zyrtare në internet.

15. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, ALUIZNI, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



Republika e Shqipërisë  
Bashkia ose Komuna (Institucioni i Autorizuar)

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË PASURISË SË PALUAJTSHME TË NDËRTUAR DERI MË  
10.08.1991 DHE TRUALLIT FUNKSIONAL TË SAJ**

Sot më \_\_\_\_\_, në mbështetje të nenit 25, pika “ç” të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenit 74 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, , të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, dhe truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie”, mora në shqyrtim kërkesën që i përket:

**Kërkues:** \_\_\_\_\_ (një nga subjektet e pikës 5)

**Me objekt:** kalimin në pronësi të pasurisë:

\_\_\_\_\_ (përshkrimi i pasurisë)

në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë/Komunës, pasi shqyrtova dokumentacionin e plotë të dosjes nr....prot...., datë....., ,

**VËREJ SE:**

**1. Rrethanat e faktit mbi të cilat mbështetet kërkesa**

(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet në dosje, dokumentacionin provues të paraqitur dhe të mbledhur, si dhe përputhshmërinë e dokumentacionit me rrethanat e faktit sipas kërkesave të pikës 6 të VKM-së nr..../2012)

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**2. Ligji i zbatueshëm dhe analiza ligjore e fakteve**

Pjesë nga ligji (neni 25 i ligjit nr. 33/2012 dhe VKM- nr..../2012)



**3. Konkluzioni**

(Konkluzion të qartë nëse përmbushen të gjitha kriteret ligjore dhe e pranoni kërkesën ose nëse një prej kriterëve nuk përmbushet dhe e refuzoni kërkesën, në mënyrë të plotë apo të pjesshme)

---

---

---

**Për këto arsye,**

**VENDOSA:**

a) Kalimin në pronësi

---

*(përshkrim i plotë dhe i sakte i truallit me sipërfaqen e kufizimet përkatëse sipas dokumentacionit ligjor)*

**Subjektit**

*(gjeneralitet e subjektit sipas certifikatës familjare të vitit 1991, numri dhe data e trashëgimisë dhe pjesët takuese të secilit të renditura sipas dëshmisë së trashëgimisë)*

- b) Këtij vendimi i bashkëlidhet dosja e plotë, relacioni teknik dhe dokumentacioni provues si dhe çdo korrespondence e Institucionit të Autorizuar
- c) Vendimi hartohet në \_\_\_ kopje
- ç) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë gjykatës së rrethit gjyqësor \_\_\_\_\_ brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ dhe hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË/KOMUNËS**  
(emër mbiemër, firme, vule)

---



## UDHËZIM

Nr. 3488/1, datë 23.8.2012

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 6.1.2012 “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, me propozim të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimet nr. 58 dhe 59, datë 17.7.2012,

#### UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 6.1.2012 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrës”, në lidhjen që i bashkëlidhet udhëzimit bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kapitullin 1 në pikën 1.2 “Tarifat e Portit dhe të kanalit”, nën-pika 1 “Tarifat e Portit dhe të kanalit për anije për prekje”, germa “a” ndryshohet si më poshtë:

a) Për tragete deri në 13 000 GT (T1)	€/GT	0.15
Për tragetet mbi 13.000 GT deri 20 000 GT për çdo GT mbi 13.000 (T2)	€/GT	0.08
Për tragetet mbi 20.000 GT për çdo GT mbi 20.000	€/GT	0.04

Pas pikës “a” shtohet pika a/1 me këtë përmbajtje:

a/1 Tarifë për çdo prekje trageti, mbi 20 prekje në muaj, për çdo kompani 20% zbritje për 1 (një) linjë operimi.

Përfshihen nga aplikimi i pikës a/1 më sipër periudhat e pikut, 15 korrik deri 15 shtator dhe 15 dhjetor deri 15 janar.

2. Në kapitullin 2 në pikën 3.3 “Tarifat për përpunimin e mallrave të rënda rifuzho”, artikulli 4 “Çimento rifuzo me pompë vakuumi”, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

<b>Tarifa e përpunimit të mallrave të rënda rifuzo</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
4/1 Çimento rifuzo me pompë vakuumi, për eksportin e volumeve të mëdha të përpunimit mbi 200 000 tonë në vit.	Lekë/tonë	424

Kjo tarifë aplikohet mbi të gjithë sasinë e eksportuar për periudhën 1.6.2012 deri 31.12.2012, nëse gjatë kësaj periudhe janë eksportuar nga i njëjti subjekt përdorues jo më pak se 80 000 tonë çimento rifuzo.

3. Në kapitullin 2 në pikën 3.7 “Tarifa e përpunimit të mallrave gjenerale”, artikulli 6 “Ngarkesa të paletizuara dhe të prepaketuara (big bags, slinga etj.)”, shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

<b>Tarifa e përpunimit të mallrave gjenerale</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
6/1 Çimento me slinga, për stimulimin e volumeve të mëdha të eksportit mbi 150 000 tonë në vit.	Lekë/tonë	570

Kjo tarifë aplikohet mbi të gjithë sasinë e eksportuar për periudhën 1.6.2012 deri 31.12.2012, nëse gjatë kësaj periudhe janë eksportuar nga i njëjti subjekt përdorues, jo më pak se 70 000 tonë çimento slinga.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

**Ridvan Bode**

MINISTRI I PUNËVE  
PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.9.2012  
Doli nga shtypi më 19.9.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë